


AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	06.04.2012
REFERENC-Ë:	AKK-DPK
PËR/ZA/TO:	z. Arben Gjuka Drejtor i Përgjithshëm në Korporatën Energjetike të Kosovës
CC:	z. Driton Pruthi Drejtor i Prokurimit në KEK
NGA/OD/FROM:	z. Hasan Preteni Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit <i>H. Preteni</i>
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin "Ruajtja dhe sigurimi i objekteve të KEK-ut"



I nderuari z. Pruthi

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 pika 12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1 pika 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin " Ruajtja dhe Sigurimi i Objekteve të KEK-ut. me numër prokurimit KEK-12-027-211 ofron këtë:

OPINION

Ju si autoritet kontraktues Zyra Prokurimit – Korporata Energjetike e Kosovës t'i ndërmerni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të cekura në arsyetim, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës nr. 04-L/042.

Arsyetim

Autoriteti kontraktues, në dosjen e tenderit "shërbime" të procedurës së hapur me nr. të prokurimit KEK-12-027-211 me titull "Ruajtja dhe Sigurimi i objekteve të KEK-ut , në Pjesën, Seksioni II, Fleta e të dhënave të tenderit të pika 2.5 ndarja në loto këtë tender e ka ndare në dy pjesë (Loto) :

1

KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
KOSOVSKA ENERGETSKA KORPORACIJA d.d.

Nr. 1721 dt. 06.04.2012
KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS

- Pjesa nr.1 Divizioni i qymyrit dhe divizioni i gjenerimit
- Pjesa nr. 2 Divizioni rrjetit të furnizimit.

Ne këtë pike autoriteti konkurrues kërkon nga ofertuesit që tenderin e tyre ta paraqesin për të gjitha pjesët (Llotot) meqë dhe përzgjedhja e fituesit do të jetë për tender si tersi e jo për pjesë. Do të nënshkruhen dy kontrata dhe atë kontrata do të jetë për pjesë. Andaj autoriteti kontraktues kërkesat nga kjo piken duhet ti përgatisë sipas nenit 2. te dosjes se tenderit për procedurat e tenderimit.

Autoritet kontraktues, në dosjen e tenderit "Shërbime " të procedurës së hapur me nr. të prokurimit KEK-12-027-211 me titull "Ruajtja dhe Sigurimi i objekteve te KEK-ut , në Pjesën, Seksioni II, Fleta e të dhënave të tenderit te neni 9.1 pika (a) i Dosjes së tenderit , Kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale , ka kërkuar që O . E të ketë të kualifikuar dhe me përvojë Personelin Kryesor (Projekt Menaxherin dhe Mbikëqyrësin e Zonave) i cili do të mbikëqyr dhe zbatoj kontratën.

Zyra e prokurimit këto kërkesa i ka shpalosur edhe një here te Aneksi 6 pika tre (3) tenderi ekonomikisht më i favorshëm, ku ka paraparë (Kompetencat e Personelit kryesor) pesha e këtij nën kriteri është 25 %. (Në kuadër të nën kriterit tre (Kompetencat e Personelit kryesor) A. K te pika 2. Përvoja në vite ka kërkuar që projekt menaxheri i cili do të ketë më tepër se 7 vite përvojë në shërbimin e sigurimit ai / ajo do të marr 20 pikë, nëse posedon 5 deri 7 vite do te merr 10 pike, ata që posedojnë më pak se 5 vite nuk do te marrin pike) Me aktin e përsëritjes (dyfishimit) të kërkesave të njëjta të tenderit, Autoriteti Kontraktues ka shkelur Ligjin për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, dhe të njëjtat kriter nuk i ka pagatitur sipas Ligjit për shërbime Private te Sigurisë 04/L004 konkretisht këto dispozita :

- Dispozitën e nenit **52.4** të LPP-së **04/L-042**.
- Dispozitën e nenit **18.5** të Ligjit për Shërbime Private të Sigurisë **04/L004**.

Autoriteti Kontraktues me rastin e përgatitjes së dosjes së tenderit te neni 9.2 pika (c) ka kërkuar një listën që specifikon secilin projekt të operatorit ekonomik të realizuar në periudhën e shkuar tre vjeçare, të përcjella me certifikata nga autoriteti kontraktues për kryerje dhe /ose përfundim të kënaqshëm të projekteve më të rëndësishme duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve dhe / ose aktiviteteve dhe do të specifikojë nëse janë kryer dhe/ose përmbushur në përputhje me praktikat dhe standardet më të mira ndërkombëtare. Këto duhet të vërtetohet dhe dëshmojnë kryerjen e shërbimeve të sigurimit fizik, në vlerë së paku 2 milion €, gjatë tre (3) viteve të fundit me jo më shumë se me katër (4) kontrata me autoritetet kontraktuese, nga kjo rrjedh se autoriteti kontraktues në këtë pikë ka bere shkelje të nenit **69** pika **4.2** dhe nenit **7** te LPP-së 04/L-042.

Me respekt!